



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE**

Nr. 1158/prot.
1

Tiranë më 17. 1. 2018

Lënda: Mendim mbi një projektvendim të Këshillit të Ministrave

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.4252 Prot., datë 06.07.2018, projektvendimi “Për llojet, mënyrën e shkëmbimit dhe e përpunimit të informacionit e të dhënave statistikore, të kërkuara nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”, vlerësohet i hartuar konform ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

Me qëllim garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale edhe gjatë publikimit të informacionit dhe të dhënave statistikore nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, vlerësojmë që pika 7 e projektvendimit të riformulohet si vijon:

“7. Shkëmbimi i informacionit dhe të dhënave statistikore nga strukturat shtetërore përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor si dhe publikimi i informacionit sipas pikës 5 të këtij projektvendimi, bëhet në përputhje me parashikimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale dhe garantimin e konfidencialitetit.”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

